

Thirrje publike nr. 01/012013

1. Furnizues

1.1. Furnizues: Universiteti i Evropës Juglindore - Tetovë

2. Lënda e furnizimit

2.1. Furnizim me vajguri dhe derivate tjera të naftës (detajet janë dhënë në specifikacion).

2.2. Lënda e furnizimit nuk është e ndashme.

2.3. Thirrja është publike, me të drejte për pjesëmarrje të të gjithë operatorëve ekonomik të vendit dhe të huaj të regjistruar për veprimtarinë e cila është lëndë e furnizimit.

3. Sasia e furnizimit dhe marrja e materialit tenderik

3.1. Sasia dhe lloji i furnizimit janë të dhëna në materialin tenderik.

3.2. Detaje tjera lidhur me thirrjen publike mund të merrni nëpërmjet e-mailit: procurement@seeu.edu.mk

4. Përmbajtja e ofertës

4.1. Oferta duhet të përmbajë: emër, adresë, selia e ofertuesit, numri i xhirollogarisë, numri tatimor dhe banka deponuese;

- Vërtetime (çertifikata) të dhënë nga organe kompetente, organizata dhe persona tjerë juridik përgjegjës për kontrollin e cilësisë me të cilën do të vlerësohet përshtatshmëria e prodhimit.

4.2. Vajguri dhe derivatet e naftës të jenë me cilësi në përputhje me Rregulloren për cilësinë e lëndëve djegëse (Fletorja zyrtare e R.M. nr. 88/2007, 91/2007, 97/2007, 105/2007, 157/2007, 15/2008, 78/2008, 156/2008 dhe 81/2009).

4.3. Oferta duhet të plotësohet në formularin e bashkangjitur në web faqen e Universitetit.

- Në çmimin përfundimtar të jenë të llogaritura edhe transporti dhe nëse është kompani e huaj atëherë edhe shpenzimet tjera.

4.4. Në qofte se si ofertues paraqitet operator ekonomik i vendit apo i huaj, oferta duhet të jetë e përkthyer në gjuhën maqedonase ose gjuhën shqipe, ndërsa çmimi mund të paraqitet me valutë tjetër (konvertibile) e cila llogaritet sipas listës së valutës të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë (kursi i mesëm) i cili aplikohet në ditën e hapjes së ofertave.

4.5. Oferta duhet të përmbajë menyrën e pagesës - definuar qartë.

4.6. Oferta duhet të ketë afat prej 120 ditësh.

5. Dokumentacion me të cilin ofertuesi dëshmon gjendjen ekonomike dhe financiare

- Dokument për veprimtari të regjistruar si dëshmi se është i regjistruar si operator ekonomik i vendit apo i huaj për kryerjen e veprimtarisë lidhur me lëndën e thirrjes publike, të lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë;
 - Leje nga organi kompetent për punë (veprimtari) për operatorë ekonomik;
 - Dokument për bonitet i lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë;
 - Vërtetim se nuk është hapur procedurë falimentimi;
 - Vërtetim se nuk është hapur procedurë për likuidim;
 - Vërtetim se nuk i është kumtuar sanksion kundërvajtës - ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës, gjegjësisht ndalesë të përkohshme për kryerjen e veprimtarisë së veçantë - Vërtetim nga gjykata;
 - Vërtetim nga Drejtoria për të hyra publike për tatime të paguara, kontribute dhe detyrime të tjera;
 - Deklaratë se në 5 vitet e fundit nuk është kumtuar aktgjykim i plotfuqishëm për pjesëmarrje në organizata kriminale, korrupsion, mashtrim ose larje të parave;
- Dokumentet e lartpërmendura nuk duhet të jenë më të vjetra se 6 muaj, ndërsa dorëzohen në original ose kopje të noterizuara.
- Operatori ekonomik i huaj i dorëzon dokumentet e lartpërmendura të lëshuara nga institucione përkatëse të huaja.
- Raporti i revizorit dhe dokumentet tjera të lëshuara nga institucioni përkatës nga vendi i huaj dhe në gjuhë të huaj duhet të jete i përkthyer në gjuhën shqipe ose gjuhën maqedonase dhe i vërtetuar nga përkthyes gjyqësor.
- Ofertat të cilat nuk do t'i përmbajnë dokumentet e lartpërmendura do të llogariten si të pakompletuara dhe të njejtat nuk do të shqyrtohen.

6. Dokumente me të cilat ofertuesi dëshmon aftësinë teknike ose profesionale

- Listë të furnizimeve të kryera për furnizimin për të cilin dorëzohet ofertë, të kryera në tre vitet e fundit, me vlera, data dhe shfrytëzuesit (listë referuese) sipas kushteve nga dokumentacioni i tenderit;
- Vërtetim nga furnizuesi për furnizime të kryera për tre vitet e fundit për përshtatshmërinë, kryerjen në kohë dhe me cilësi të furnizimit nga ofertuesi.

7. Kriteret për zgjedhjen e ofertës më të përshtatshme:

- Cilësi;
- Çmim;
- Referenca;
- Mënyra dhe afati i pagesës;
- Afati i furnizimit;

Në bazë të kriterëve të lartpërmendura zgjidhet oferta më e përshtatshme.

8. Mënyra dhe afati i dorëzimit të ofertave

Ofertuesi duhet ta dorëzojë ofertën në një kopje origjinale në zarf të mbyllur, në të cilën duhet të jete shenja „Mos e hap”, të jetë e firmosur nga ana e përgjegjësit të ofertuesit. Në zarfën e mbyllur duhet të ketë edhe dy zarfa tjera, të mbyllura. Njëra nga zarfat e mbyllura e përmban ofertën, me shenjën „Oferta”, ndërsa zarfi tjetër përmban

dokumentacionin e nevojshëm, me shenjën „Dokumentacioni”, në të cilën duhet të jetë edhe adresa e saktë e ofertuesit.

Ofertat të cilat nuk i përmbajnë të gjitha të dhënat të kërkuara në thirrjen, gjegjësisht në të cilat nuk është bashkangjitur dokumentacioni i kërkuar do të llogariten si të pakompletuara dhe nuk do të shqyrtohen.

Afati për dorëzimin e ofertave është deri më 25.01.2013, ora 16:00

Ofertat të cilat do të dorëzohen pas afatit nuk do të shqyrtohen.

Ofertat mund të dorëzohen nëpërmjet postës në adresën: Universiteti i Evropës Juglindore, „Ilindenska” pn 1200 Tetovë ose të dorëzohen në arkivin e Universitetit të EJK, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00.

9. Dispozitat përfundimtare

9.1. Ofertat e dorëzuara pas kalimit të afatit dhe të cilat nuk janë të përgatitura sipas thirrjes publike nuk do të shqyrtohen.